



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr. B.F. No. 01 / 809	
DATA 08. 06. 2022	
PRISHTINË - A	

KGJK.Nr.276/2022

Datë: 31 maj 2022

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Ferki Xhaferi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, duke vendosur sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK /05/ 2022/ GJTHM-ADGJTHM.nr.02/2021, të datës 06.05.2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me 31 maj 2022, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

**Ferki Xhaferi**, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

#### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje “Këshilli”), me datë 16 shkurt 2022 ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor me pretendim se Ferki Xhaferi, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, mund të ketë neglizhuar shqyrtimin e lëndës P.nr. P.nr.235/2018 dhe me këtë ka kryer shkelje disiplinore nga neni 5-shkeljet disiplinore për gjyqtarë, paragrafi 2, pika 2.7- në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj, të përcaktuara në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent, të fillojë hetimin disiplinor dhe ka propozuar që ndaj të njëjtit, në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore, t’i shqiptohet njëri nga sanksionet disiplinore të parapara sipas nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

Kërkesës së cekur më lartë, Autoriteti Kompetent ia ka bashkangjitur ankesën e ankuesit nga Vushtrria; Deklaratën e gjyqtarit Ferki Xhaferi si dhe plotësimin e deklaratës të dhënë sipas kërkesës së Autoritetit Kompetent, të datës 14 janar 2022 dhe 9 shkurt 2022.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.101/2022, të datës 24 shkurt 2022 ka themeluar panelin hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK /05/ 2022/ GJTHM-ADGJTHM.nr.02/2021.Paneli hetimor me datë 6 maj 2022 i ka paraqitur Këshillit raportin e shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Pas pranimit të raportit të Panelit Hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore, Këshilli me datë 31 maj 2022, ka mbajtur seancë dëgjimore, ku morën pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor gjyqtarja Hidajete Gashi dhe subjekti i hetimit disiplinore, gjyqtari Ferki Xhaferi.

Kryesuesja e panelit hetimor në seancën dëgjimore në Këshill ka deklaruar se bazuar në Ligjin Nr.06/l-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, paneli ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore më datë 12 prill 2022, me ç'rast është dëgjuar subjekti i hetimit disiplinor. Në këtë seancë dëgjimore të panelit është propozuar që në cilësinë e dëshmitarit të ftohet ndihmës administratorja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri.

Paneli hetimor ka gjetur fakte të pakontestuar lidhur me dorëzimin e aktakuzës në gjykatë me datë 7 maj 2018, gjyqtari Xhaferi lëndën kontestuese me numër P.nr.235/2018 e ka pranuar me datë 18 maj 2018, shqyrtimi fillestar i rastit përkatës është mbajtur me datë 10 shtator 2020, i pandehuri nuk kishte paraqitur kundërshtimin provave dhe kërkesë për hudhje të aktakuzës, ndërsa gjyqtari Xhaferi shqyrtimin gjyqësor e ka caktuar me datë 3 dhjetor 2021.Shqyrtimi gjyqësor për rastin kontestues është përfunduar me datë 17 dhjetor 2021, ku edhe e kishte shpallur aktgjykimin, ndërsa përpilimi i aktgjykimit është bërë me datë 30 dhjetor 2021.Lënda P.nr.235/2018, sipas ankesës me datë 24 janar 2022, ishte shkuar në gjykatën e Apelit.

Këtë gjendje faktike paneli hetimor e ka vërtetuar me faktet dhe provat të cilat ja kanë bashkangjitur raportit me shkrim: Ankesa e ankuesit ; Procesverbali i vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor për lëndën P.nr.235/2018, i datës 16.12.2021; Kërkesa e Autoritetit Kompetent për fillimin e hetimeve disiplinore; Deklarata e Ndihmës Administratores dhënë me datë 19.04.2022; Deklarata e subjektit të hetimit dhënë në seancën dëgjimore me datë 12.04.2022; CD-ën e seancës dëgjimore; Raporti i ngarkesës me lëndë për periudhën kohore 2018-2020, për subjektin e këtij hetimi; Procesverbali nga seanca gjyqësore e mbajtur me datë 3 dhjetor 2021 lidhur më çështjen penale P.nr.235/18; Vendimin mbi angazhimin e gjyqtarit Ferki Xhaferi tek Paneli Zgjedhor për ankesa dhe parashtesa, PZAP.nr.289/2019, i datës 16.09.2019; Vendimin për caktim të ushtruesit të detyrës së mbikëqyrësit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, si dhe Urdhëresa për shtyrjen e shqyrtimit fillestar të datës 4 maj 2020, kopjet e flet kthesave për dorëzimin e kësaj urdhërese, kjo urdhëresë është pranuar nga i pandehuri dhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë me datë 4 maj 2020, ndërsa për të dëmtuarin me datë 4 maj 2022 është lënë konstatimi “ pala është kërkuar në këtë adresë por jeton në fshatin Bukosh”.

Paneli hetimor i ka dorëzuar për shqyrtim dhe vendimmarrje KGJK-së këtë raport me faktet dhe provat e mbledhura për të vendos lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga gjyqtari Ferki Xhaferi gjatë procedimit të lëndës P.nr.235/2018.



Gjyqtari Ferki Xhaferi në seancën dëgjimore në Këshillit të mbajtur me datë 31 maj 2022, ka deklaruar se nuk ka pasur parashkrim relativ të lëndës penale kontestuese, ka qenë e caktuar seanca me datë 4 maj 2020, po i është dashur që të nxjerr urdhëresë për shtyrje të seancës për shkak të gjendjes së pandemisë dhe rrezikuar për përhapjes së Covid/2019, duke i zbatuar edhe vendimet e KGJK-së, që për shkak të gjendjes së pandemisë të merren parasysh vetëm çështjet urgjente.

Me tutje ka deklaruar se me lëshim e urdhëresës është ndërprerë parashkrimi relativ. Po ashtu gjatë viti 2020 përpos angazhimeve të tjera, ka qenë i angazhuar edhe në mbikëqyrjen e degës së gjykatës në Vushtrri për shkak të infektimit me Covid/2019 të dy gjyqtareve mbikëqyrës. Në këtë periudhë kohore gjyqtari Ferki Xhaferi ka qenë edhe pa procesmbajtëse.

Ndërsa sa i përket pretendimit të ankuesit, që i njëjti ka qenë palë e dëmtuar në lëndën penale kontestuese se i akuzuari në këtë rast e kishte kanosur me fjalët “ta kallxoj unë ty” gjyqtari Xhaferi ka deklaruar se nuk e kishte dëgjuar. Gjyqtari Xhaferi në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.12.2021, e ka pyetur edhe prokuroren e rastit se a e ka dëgjuar kërcënimin e pretenduar të palës së dëmtuar nga i akuzuari, e njëjta kishte deklaruar se jo nuk ka dëgjuar asnjë kërcënim.

Më tutje gjyqtari Xhaferi ka theksuar se lënda në fjalë ka qenë lëndë në grupin e lëndëve të lehta dhe kjo edhe ka qenë arsyeja se pse nuk ka mundur të trajtohet me herët për shkak se ka qenë i ngarkuar me një numër të madh të lëndëve të rënda penale dhe të natyrës urgjente. Ka shtuar se nuk ka pasur ndonjë dashje, në kushtet në të cilat ka punuar në periudhën e pandemisë, ka qenë i përkushtuar shumë. Është hera e para që është prezantuar para Këshillit për ndonjë pretendim për shkelje disiplinore.

Për t'i vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli administroi dhe vlerësoi këto prova: Raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura, i dorëzuar në KGJK me datë 04.05.2022; Kërkesën për inicim të procedurës disiplinore të Autoritetit Kompetentë, të datës 06.05.2022; Ankesën e ankuesit nga Vushtrria; Deklaratën e gjyqtarit Ferki Xhaferi si dhe plotësimin e deklaratës të dhënë sipas kërkesës së Autoritetit Kompetent, të datës 14 janar 2022 dhe 9 shkurt 2022; Procesverbalin i vazhimit të shqyrtimit gjyqësor, të datës 16.12.2021, Procesverbalin e panelit hetimor të datës 24 mars 2022; Transkriptin e seancës dëgjimore të panelit hetimor të mbajtur me datë 12 prill 2022; Transkriptin e seancës së radhës së panelit hetimor të mbajtur me datë 19 prill 2022; si dhe Kërkesën urgjente për plotësimin e tri (3) pozitave për pozitën zyrtare ligjore të Mbikëqyrësi të degës së gjykatës në Vushtrri z.Rifat Bllata të drejtuar për Drejtorin e SKGJK-së.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit gjyqtarit Ferki Xhaferi, Këshilli në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 31 maj 2022, konstatoi se gjyqtari Ferki Xhaferi, me rastin e procedimit të çështjes penale të evidentuar P.nr.235/2018, nuk ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli ka gjetur se gjyqtari Ferki Xhaferi nuk është përfshirë në shkelje disiplinore siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent. Bazuar në deklaratën e gjyqtari Xhaferi, të dhënë para panelit hetimor dhe shkresat e tjera të bashkangjitura raportit të panelit, Këshilli konstatoj se për çështjen penale P.nr.235/2018, gjyqtari ka ndërmarr veprime pa arritur parashkrimi relativ. Kishte nxjerr urdhëresë për shtyrje të seancës së datës 07.05.2020, për shkak të përhapjes së Covid /2019, dhe në zbatim edhe të vendimeve të Këshillit.

Gjyqtari Xhaferi gjatë kësaj periudhe sipas regjistrimit për regjistrimin e lëndëve ka qenë i ngarkuar me një numër të madh të lëndëve. Për një periudhë prej shtatë muaj ka mbikëqyrur edhe degën e gjykatës në Vushtrri, për shkak të infektimit me Covid/2019 të gjyqtarit mbikëqyrës.

Në bazë të provave dhe dëshmisë së ndihmës administrative së degës së gjykatës në Vushtrri, është vërtetuar se gjyqtari Ferki Xhaferi gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur procesmbajtës/zyrtare ligjore. Gjatë vitit 2019, gjyqtari Xhaferi ka qenë i angazhuar edhe në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP.


Këshilli ka konstatuar se gjyqtari Ferki Xhaferi, për lëndën penale kontestuese të evidentuar P.nr.235/2018, kishte ndërmarr veprime, ka nxjerr edhe vendimin meritor i cili sipas ankesës ka shkuar në gjykatën e Apelit, ku edhe kishte arritur parashkrimi relativ.

Shkeljet e pretenduara nga Autoriteti Kompetent nuk janë provuar me provat e administruara, të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës i panelit hetimor. Ky raport është vlerësuar si i besueshëm pasi paneli hetimor në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore, ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve.

Këshilli në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime vendosi se gjyqtari Ferki Xhaferi nuk është përgjegjëse për shkelje disiplinore siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent dhe të njëjtin e ka liruar nga përgjegjësia disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.276/2022, datë: 31 maj 2022**



Zëvendës Kryesues i Këshillit Gjyqësor të  
Kosovës

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Ljiljana Stevanovic, Kryetare e Gjykatës Themelore në Mitrovicë;*
- *Ferki Xhaferi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri;*
- *Arkivit.*